



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 16/3 Prot.

Tiranë, më 29 / 02 / 2024

VENDIM

Nr. 8, datë 29 / 02 / 2024

MBI


“MIRATIMIN NË FAZË TË DYTË TË LISTËS PËR PËRJASHTIM NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT PËR STUDENTËT E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE (BACHELOR) PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024 NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”

Bordi i Administrimit të Universitetit të Arteve, mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 269, datë 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit” (i ndryshuar), në Urdhrin e Rektorit të Universitetit të Arteve nr. 93/1, dt. 03.01.2024, “Për fillimin e procedurës së pranimit të aplikimeve dhe shqyrtimit të dokumentacionit (faza 2), nga ana e fakulteteve të UART, për studentët të cilët përfitojnë përjashtim ose reduktim nga tarifa vjetore e shkollimit, për vitin akademik 2023-2024, në Universitetin e Arteve”, bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga çdo student aplikues, procesverbaleve nr. 886/7 Prot, datë 29.01.2024 (FAB), nr. 16/2 prot., datë 29.01.2024 (FM), nr. 16/3 prot., datë 29.01.2024 (FAS), me listat e studentëve aplikantë të përgatitura nga 3 (tri) Kryetaret e Degëve të secilit fakultet, pas relativitetit të tyre dhe shqyrtimit e diskutimit nga Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës për përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit, të studentëve aplikues renditur në Shtojcën nr. 1 dhe Shtojcën nr. 2¹ bashkëlidhur këtij vendimi që ndjekin studimet në ciklin e parë të studimeve Bachelor pranë të Fakultetit të Muzikës, Fakultetit të Arteve të Bukura dhe Fakultetit të Artit Skenik në Universitetin e Arteve, për vitin akademik 2023-2024.

¹ Shtojca nr. 1 dhe Shtojca nr. 2 kanë përmbajtje të njejtë, me ndryshimin e vetëm se në shtojcën nr. 1 studentët renditen në formatin emër+atësi+mbiemër, ndërsa në shtojcën nr. 2, ata identifikohen me numër matricullimi.



2. Ky vendim, së bashku me *Shtojcën nr. 2* (në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar) të përcillet pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL).
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Fakulteti i Muzikës, Fakulteti i Arteve të Bukura dhe Fakulteti i Artit Skenik pranë Universitetit të Arteve si dhe Drejtoria Ekonomike.
4. Publikimin e vendimit si dhe *Shtojcës nr. 2* në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Lavdrim SAHITAJ



(Kryetar)

Jeton SHEHU

(Anëtar)

Ergis SEFA

(Anëtar)

Vladimir Llakaj



(Anëtar)

Prof. Besnik Bisha



(Anëtar)

Prof.Asoc.Dr. Sokol SARACI



(Anëtar)

Lorenc VANGJELI



(Anëtar)



FAKULTETI I MUZIKËS

Kriteri 2				
Nr.	Numri i matrikullimit	Fakulteti	Programi i studimit	Viti (1-3)
1	AA212A110037	Muzikë	Fizarmonikë	2 (dytë)
2	AA212A110030	Muzikë	Violë	2 (dytë)
Kriteri 3				
3	AA212A100041	Muzikë	Klarinetë	3 (tretë)
Kriteri 9				
4	AA212A120040	Muzikë	Violë	1 (parë)
5	AA145A120004	Muzikë	Pedagogji muzikore	1 (parë)

FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA

Kriteri 2				
Nr.	Numri i matrikullimit	Fakulteti	Programi i studimit	Viti (1-3)
1	AA211A120027	Arte të Bukura	Pikturë	1 (parë)

FAKULTETI I ARTIT SKENIK

Kriteri 2				
Nr.	Numri i matrikullimit	Fakulteti	Programi i studimit	Viti (1-3)
1	AA214A110031	Artit Skenik	Koreografi	2 (dytë)
Kriteri 9				
2	AA214A110016	Artit Skenik	Skenografi-Koreografi	2 (dytë)

